



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 52

Tiranë – E martë, 5 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 26/2016, datë 10.3.2016	Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, i cili amendon konventën e datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për shmangien e taksimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.....
	3363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 237, datë 30.3.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 911, datë 11.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave dhe kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për nxënësit e studentët në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2015–2016”.....
	3368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 30.3.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Runa.....
	3369
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1362, datë 16.3.2016	Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit.....
	3369
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1545, datë 29.3.2016	Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi.....
	3373
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1546, datë 29.3.2016	Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.....
	3378
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1547, datë 29.3.2016	Agjencitë që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove.....
	3392

Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1548, datë 29.3.2016	Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove.....	3396
Urdhër i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 182, datë 17.3.2016	Për miratimin e rregullores “Për paraqitjen e vlerave ushqimore dhe shëndetësore të produkteve ushqimore”	3401



LIGJ
Nr. 26/2016

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT
FEDERAL ZVICERAN, I CILI
AMENDON KONVENTËN E DATËS 12
NËNTOR 1999, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KONFEDERATËS ZVICERANE PËR
SHMANGIEN E TAKSIMIT TË
DYFISHTË, LIDHUR ME TATIMET MBI
TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, i cili amendon konventën e datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për shmangien e taksimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9478, datë 24.3.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

PROTOKOLL

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN, I CILI
AMENDON KONVENTËN E DATËS 12
NËNTOR 1999, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS
ZVICERANE PËR SHMANGIEN E
TAKSIMIT TË DYFISHTË NË LIDHJE ME
TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE
KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli Federal Zviceran,

me dëshirën për të lidhur një protokoll për amendimin e Konventës, të datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Republikës së Shqipërisë, për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin (në vijim e referuar si “Konventa”),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Nënparagrafi “a”, i paragrafit 3, të nenit 2 (Tatimet e përfshira) i Konventës, zëvendësohet me nënparagrafin e mëposhtëm:

“a) në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave nga kapitali ose nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;

ii) tatimi i aktiviteteve të biznesit të vogël; dhe

iii) tatimi mbi pasurinë;

(i referuar në vijim si “Tatimi shqiptar”);”.

Neni 2

Nënparagrafi “b”, i paragrafit 1, të nenit 3 (Përkufizime të përgjithshme) i Konventës, zëvendësohet nga nënparagrafi i mëposhtëm:

“b) Termi “Zvicër” nënkupton territorin e Konfederatës Zvicerane, siç përcaktohet nga ligjet e saj në përputhje me të drejtën ndërkombëtare”.

Neni 3

Klauzola “ii”, e nënparagrafit “h”, të paragrafit 1, të nenit 3 (Përkufizime të përgjithshme) të Konventës, zëvendësohet nga klauzola e mëposhtme:



“ii) në rastin e Zvicrës, drejtuesi i Departamentit Federal të Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar”.

Neni 4

Paragrafi 1, i nenit 4 (Rezidenti) i Konventës fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve të atij shteti për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të menaxhimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe, gjithashtu, përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet vendor të tij. Ky term, megjithatë, nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për sa i përket të ardhurave nga burime në atë Shtet apo kapitalit të vendosur aty.”.

Neni 5

1. Paragrafët ekzistues 3 deri 6, të nenit 11 (Interesi) të Konventës rinumërohen si paragrafët 4 deri 7.

2. Paragrafi 3 në vijim i shtohet nenit 11 (Interesi) të Konventës.

“3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2, interesat e krijuara në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, i cili është pronari i tyre përfitues, do të tatohen vetëm në atë Shtet tjetër në masën që ky interes paguhet

a) për një skemë pensioni; ose

b) për qeverinë e atij Shteti tjetër, një nënndarje politike apo autoritet vendor të tij ose në bankën qendrore të Shtetit tjetër.”.

3. Paragrafi i rinumëruar 6, i nenit 11 (Interesi) i Konventës, fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“6. Interesat konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, në rastet kur personi që paguan interesat, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi (borxhi) për të cilin paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë

krijuar në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.”.

Neni 6

Paragrafi 5 i nenit 12 (Të drejtat e patentave, licencave etj.) të Konventës, fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“5. Të drejtat e patentave, licencave etj., konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij Shteti. Megjithatë, në rastet kur personi që paguan të drejtat e patentave, licencave etj., qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi për pagesën e të drejtave të patentave, licencave etj., dhe të drejta të tilla të patentave, licencave etj., krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto të drejta të patentave, licencave etj., do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.”.

Neni 7

Paragrafi 3, i nenit 24 (Mosdiskriminimi) i Konventës, fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e nenit 9, paragrafit 7, të nenit 11 ose paragrafit 6, të nenit 12, interesat, të drejtat e patentave, licencave etj., dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues për një rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme nën të njëjtat kushte sikur t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur fillimisht.

Në mënyrë të ngjashme, borxhet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për qëllim të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme nën të njëjtat kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezident i Shtetit të përmendur fillimisht.

Neni 8

Paragrafët e mëposhtëm 5 dhe 6, i shtohen nenit 25 (Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë) të Konventës:

“5. Ku:



a) sipas paragrafit 1, një person ka paraqitur një çështje për autoritetin kompetent të një Shteti Kontraktues mbi bazën se veprimet e njërit apo të të dyja Shteteve Kontraktuese kanë rezultuar për atë person në taksimin e tij jo në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente; dhe

b) autoritetet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur këtë çështje në pajtim me paragrafin 2 brenda tri viteve nga paraqitja e çështjes tek autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues,

çështjet e pazgjidhura, që rrjedhin nga rasti, do të dorëzohen në arbitrazh sipas kërkesës së personit. Me përjashtim të rastit kur një person i cenuar drejtpërdrejt nga çështja nuk e pranon marrëveshjen e ndërsjellë që zbaton vendimin e arbitrazhit ose autoriteteve kompetente dhe personat e cenuar drejtpërdrejt nga çështja, bien dakord për një zgjidhje të ndryshme, brenda gjashtë muajve pasi vendimi i është komunikuar atyre, vendimi i arbitrazhit do të jetë detyrues për të dyja shtetet dhe do të zbatohet pavarësisht nga afatet kohore të ligjeve të brendshme të këtyre shteteve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, vendosin me mirëkuptim reciprok, mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi.

6. Shtetet kontraktuese mund të japin për bordin e arbitrazhit të krijuar sipas dispozitave të paragrafit 5, një informacion të tillë, në masën që është e nevojshme për zbatimin e procedurës së arbitrazhit. Anëtarët e bordit të arbitrazhit u nënshtrohen kufizimeve të zbulimit të informacionit të përshkruara në paragrafin 2, të nenit 26, në lidhje me informacionin e nxjerrë në këtë mënyrë”.

Neni 9

Nenet ekzistuese 26, 27 dhe 28 të Konventës, rinumërohen si nenet 27, 28 dhe 29.

Neni 10

Neni 26 në vijim (Shkëmbimi i informacionit) shtohet në Konventë:

“Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese shkëmbejnë informacionet, siç parashikohen të jenë të nevojshme për zbatimin

e dispozitave të kësaj Konvente ose për administrimin, zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese, nënndarjeve të tyre politike apo autoriteteve vendore, në masën që ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Informacionet e marra sipas paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues, trajtohen sekrete në të njëjtën mënyrë si informacionet e marra nën ligjet e brendshme të atij Shteti dhe i zbulohen vetëm personave apo autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative), që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin apo ndjekjen ligjore të tyre në lidhje me përcaktimin e ankesave për tatimet e përmendura në paragrafin 1 ose me mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta ofrojnë informacionin në procedurat gjyqësore publike apo vendimet gjyqësore. Pavarësisht nga sa më sipër, informacioni i marrë nga një Shtet Kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera kur ky informacion mund të përdoret për qëllime të tilla të tjera sipas ligjeve të të dyja shteteve dhe të autoritetit kompetent të Shtetit që e autorizon këtë përdorim.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, nuk do të interpretohen sikur vendosin te një Shtet Kontraktues detyrimin, për:

a) zbatimin e masave administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikat administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) dhënien e informacioneve të cilat nuk mund të merren sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) dhënien e informacioneve të cilat mund të zbulonin një sekret tregtar, biznesi, sekret industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtar apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues, në pajtim me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të ndërmarë masat e tij të mbledhjes së informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, edhe pse këtij Shteti



tjetër mund të mos i nevojitet një informacion i tillë për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi që përmban fjalë të mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të mos japë më informacion vetëm për shkak se ai nuk ka interesa të brendshme në këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të mos japë informacion vetëm për shkak se informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar i caktuar ose person që vepron në një agjenci ose në një cilësi fiduciare ose për shkak se ai lidhet me interesa pronësore të një personi.”.

Neni 11

1. Paragrafi ekzistues 4 i Protokollit të Konventës rinumërohet si paragrafi 6.

2. Paragrafi i ri 4 në vijim shtohet në Protokollin e Konventës:

“4. Nenet 10, 11, 12 dhe 21:

a) Dispozitat e neneve 10, 11, 12 dhe 21 nuk zbatohen për zërin e të ardhurave të paguara sipas një transaksioni, një pjese të një transaksioni ose një serie të transaksioneve, ose që rrjedh nga një njësi ekonomike, nëse qëllimi kryesor i përfundimit apo krijimit të tij është marrja e përfitimeve sipas neneve 10, 11, 12 dhe 21, dhe nëse - duke lënë mënjane transaksionin, pjesën e transaksionit, serinë e transaksioneve ose njësinë ekonomike - zëri i të ardhurave është caktuar për një person që nuk është rezident i ndonjërit prej Shteteve Kontraktuese;

b) Dispozitat e nënparagrafit “a”, të paragrafit 2, të nenit 10, nuk zbatohen për dividendët e paguar sipas një transaksioni, një pjese të një transaksioni ose serie të transaksioneve, ose që rrjedhin nga një njësi ekonomike, nëse qëllimi kryesor i përfundimit apo krijimit të tyre është marrja e përfitimeve të nënparagrafit “a”, të paragrafit 2, të nenit 10, dhe nëse - duke lënë mënjane transaksionin, pjesën e transaksionit, serinë e transaksioneve ose njësinë ekonomike - ata dividendë janë caktuar për një person i cili nuk i plotëson kushtet e nënparagrafit “a”, të paragrafit 2, të nenit 10, në lidhje me ata dividendë;

c) Nëse - duke lënë mënjane transaksionin, pjesën e transaksionit, serinë e transaksioneve apo njësinë ekonomike - zëri i të ardhurave është caktuar për një person i cili, sipas konventës për shmangien e taksimit të dyfishtë ndërmjet Shtetit në të cilin personi është rezident (banor) dhe Shtetit në të cilin lindin të ardhurat apo sipas një marrëveshjeje tjetër, do të ketë të drejtë për përfitime në lidhje me atë zë të të ardhurave ekuivalente ose më të favorshme se ato të disponueshme në bazë të kësaj Konvente për një rezident të një Shteti Kontraktues, qëllimi kryesor i transaksionit, i pjesës së transaksionit, serisë së transaksioneve ose i njësisë ekonomike nuk do të konsiderohet të jetë marrja e përfitimeve sipas neneve 10, 11, 12 dhe 21.

Neni 12

Paragrafi 5 në vijim shtohet në Protokollin e Konventës:

“5. Neni 11

Është e kuptueshme se termi “skema e pensioneve”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton çdo plan, skemë, fond, fondacion, trust ose masë tjetër të krijuar në një Shtet Kontraktues, i cili rregullohet nga dhe përgjithësisht përjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat në atë Shtet dhe që funksionon kryesisht për të administruar ose siguruar përfitimet e pensioneve apo të daljes në pension ose për përfitimin e të ardhurave në interes të një ose më shumë skemave të tilla dhe përfshin sa më poshtë:

a) në Shqipëri, çdo skemë pensioni të mbuluar nga:

i) ligji nr. 10197, i datës 10.12.2009, “Për fondet e pensioneve vullnetare”;

ii) ligji nr. 7703, i datës 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;

iii) ligji nr. 10142, i datës 15.5.2009, “Për sigurimet suplementare shoqërore për Forcat Ushtarake të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës Kombëtare, Shërbimit të Inteligjencës, Policisë së Burgjeve, Policisë së Zjarrit, Policisë së Shpëtimit dhe i Shërbimeve të Auditimit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

iv) ligji nr. 8097, i datës 21.3.1996, “Për pensionet suplementare shtetërore për personat që kryenin funksione kushtetuese dhe punonjësit shtetërorë”;



v) ligji nr. 10139, i datës 15.5.2009, “Për pensionet suplementare shtetërore të punonjësve të universiteteve, institucioneve të arsimit të lartë, Qendrës për Studime Shqiptare, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj akademikë”;

vi) ligji nr. 150/2014, “Për pensionet e minatorëve”;

b) në Zvicër, të gjitha skemat e pensionit të mbuluara nga:

i) Akti Federal mbi sigurimin e pleqërisë dhe sigurimin e pasardhësve, i datës 20 dhjetor 1946;

ii) Akti Federal mbi sigurimin e personave me aftësi të kufizuara, i datës 19 qershor 1959;

iii) Akti Federal mbi pensionet suplementare në lidhje me sigurimin e pleqërisë, të pasardhësve dhe personat me aftësi të kufizuara, i datës 6 tetor 2006;

iv) Akti Federal mbi sigurimin e pleqërisë, sigurimin e pasardhësve dhe personave me aftësi të kufizuara, i pagueshëm për sa i përket punësimit ose vetëpunësimit, të datës 25 qershor 1982, duke përfshirë skemat e paregjistruara të pensioneve, të cilat ofrojnë planet e pensioneve profesionale; dhe

v) format e skemave individuale pensionale të njohura, të krahasueshme me planet e pensioneve profesionale, në përputhje me nenin 82 të Aktit Federal, mbi sigurimin e pleqërisë, të pasardhësve dhe personave me aftësi të kufizuara, të pagueshme për sa i përket punësimit ose vetëpunësimit, të datës 25 qershor 1982;

c) dhe çdo skemë identike ose të ngjashme të vendosur sipas legjislacionit të paraqitur pas datës së nënshkrimit të këtij Protokollit, siç është rënë dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese.”.

Neni 13

Paragrafi 7 në vijim i shtohet Protokollit të Konventës:

“7. Neni 12

Duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 12, nëse Republika e Shqipërisë lidh një Marrëveshje të çdo lloji dhe natyre apo një Marrëveshje të Tatimit të Dyfishtë, me një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, duke siguruar norma tatimore, më të ulëta se 5 për qind, siç parashikohet në këtë nen

12, kjo normë më e ulët do të jetë automatikisht e zbatueshme në këtë Konventë sapo ajo të hyjë në fuqi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe këtij shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane.

Neni 14

Paragrafi 8 në vijim i shtohet Protokollit të Konventës:

“8. Neni 26

a) Është e kuptueshme që shkëmbimi i informacionit kërkohet vetëm pasi Shteti kërkues Kontraktues t'i ketë shteruar të gjitha burimet e rregullta të informacionit, të disponueshme sipas regjimit të brendshëm tatimor.

b) Është e kuptueshme që autoritetet tatimore të Shtetit kërkues do të sigurojnë informacionin e mëposhtëm për autoritetet tatimore të Shtetit të kërkuar, në kërkesat për informacione sipas nenit 26:

i) identiteti i personit nën procesin e marrjes në pyetje apo hetim;

ii) periudha e kohës për të cilën është kërkuar informacion;

iii) një deklaratë mbi informacionin e kërkuar, duke përfshirë natyrën e saj dhe formën në të cilën Shteti kërkues dëshiron të marrë informacion nga Shteti i kërkuar;

iv) qëllimin tatimor për të cilin kërkohet informacioni;

v) në masën e njohur, emrin dhe adresën e çdo personi që besohet të jetë në zotërim të informacionit të kërkuar.

c) Është e kuptueshme se referenca për “rëndësinë e parashikueshme”, ka për qëllim të sigurojë shkëmbimin e informacionit në çështjet tatimore deri në masën e gjerë të mundshme dhe, në të njëjtën kohë, të sqarojë se Shtetet Kontraktuese nuk janë të lira për t'u angazhuar në “ekspedita të peshkimit” ose të kërkojnë informacione, që nuk mund të jenë të rëndësishme për çështjet tatimore të tatimpaguesit të caktuar. Ndërsa nënparagrafi “b” përmban kërkesat e rëndësishme procedurale, të cilat synojnë të sigurojnë që nuk do të ndodhin “ekspedita të peshkimit”, klauzolat “i” deri “v”, të nënparagrafit “b”, megjithatë, nuk duhet të interpretohen në një mënyrë që pengon shkëmbimin efektiv të informacionit.



d) Është e kuptueshme se neni 26 nuk kërkon që Shtetet Kontraktuese të shkëmbejnë informacion mbi baza automatike apo spontane.

e) Është e kuptueshme se në rast të një shkëmbimi të informacionit, rregullat procedurale administrative të lidhura me të drejtat e tatimpaguesve, të parashikuara në Shtetin e kërkuar Kontraktues mbeten të zbatueshme. Kuptohet më tej, se këto dispozita synojnë garantimin për tatimpaguesin të një procedure të drejtë dhe jo parandalimin ose vonimin padrejtësisht të procesit të shkëmbimit të informacionit.”.

Neni 15

1. Secili Shtet Kontraktues do të njoftojë tjetrin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të kërkuara nga ligji i tij për hyrjen në fuqi të këtij Protokollit. Protokollit do të hyjë në fuqi në datën më të vonë të marrjes së këtyre njoftimeve.

2. Dispozitat e Protokollit do të kenë efekt:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim mbi shumat e paguara ose të kredituara më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit;

b) në lidhje me tatimet e tjera për vitet tatimore që fillojnë më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit;

c) në lidhje me nenin 25, paragrafët 5 dhe 6, për procedurat e mirëkuptimit të ndërsjellë, të cilat janë:

i) të mbetura pezull ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese me hyrjen në fuqi të Protokollit (në raste të tilla, periudha trevjeçare, sipas nënparagrafit “b” fillon me hyrjen në fuqi të këtij Protokollit); ose

ii) iniciuar pas asaj date;

d) në lidhje me nenin 26, ndaj informacionit që lidhet me vitet fiskale, të cilat fillojnë më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 9 shtator 2015, në gjuhën shqipe, frënge dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim ndërmjet tekstit në gjuhën frënge dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 237, datë 30.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 911, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE E PAGESAVE DHE KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, PËR NXËNËSIT E STUDENTËT NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 911, datë 11.11.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në nënpikën 6.1, të pikës 6, data “31.12.2015” zëvendësohet me “15.4.2016”.

2. Në nënpikën 6.2, të pikës 6, data “15.1.2016” zëvendësohet me “29.4.2016”.

3. Në pikën 14, data “15.1.2016” zëvendësohet me “29.4.2016”.

4. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga këshillat bashkiakë për vitin shkollor 2015-2016, për të gjitha kategoritë e shkollave/institucioneve të arsimit të lartë, është data 15 prill 2016.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 251, datë 30.3.2016

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
TË MJEKIMIT TË Z. ARBEN RUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Runa, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale, përkatëse, të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 1362, datë 16.3.2016

**MBI RREGULLAT NË VENDOSJEN E
TARIFAVE TË AEROPORTIT¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7(ç), të nenit 11, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e përbashkëta mbi vendosjen e tarifave aeroportuale në aeroportet e Republikës së Shqipërisë.

2. Ky udhëzim do të zbatohet për çdo aeroport të hapur për trafik tregtar, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, trafiku vjetor i të cilit është mbi pesë milionë lëvizje pasagjerësh dhe kur nuk ka një të tillë, në aeroportin me lëvizjen më të lartë të pasagjerëve në vend.

3. Duke konsideruar detyrimet e shtetit shqiptar, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat për publikimin e listës së aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të cilët aplikohet ky udhëzim. Kjo listë do të përditësohet çdo vit.

4. Ky udhëzim nuk do të zbatohet:

4.1 për tarifën e mbledhura nga të ardhurat e shërbimeve të lundrimit ajror, në rrugët ajrore (*en-route*) dhe terminal, në përputhje me përcaktimet e urdhrit të ministrit nr. 70, datë 13.5.2013, “Për miratimin e rregullores për

¹ Ky udhëzim përaftron plotësisht direktivën e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës nr. 2009/12/KE, të 11 marsit 2009, “Për tarifën e aeroportit”.



përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e lundrimit ajror”,

4.2 për tarifën e mbledhura nga të ardhurat e shërbimeve në tokë (*ground handling*), të referuara në parashikimet e rregullores përkatëse,

4.3 për tarifën që merren për financimin e asistencës për pasagjerët me paafësi për të lëvizur dhe pasagjerët me lëvizshmëri të kufizuar.

5. Ky udhëzim nuk kufizon të drejtën e organeve kompetente në Republikën e Shqipërisë për të aplikuar masa shtesë rregullative, në lidhje me ndonjë ent menaxhues aeroportit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto masa, të cilat nuk duhet të bien në kundërshtim me këtë udhëzim ose dispozita të tjera përkatëse që rregullojnë këtë fushë, mund të përfshijnë masa të mbikëqyrjes ekonomike, si miratimin e sistemeve të tarifave dhe/ose nivelin e tyre, duke përfshirë edhe metoda tarifimi nxitëse apo rregullore për tavanin e çmimit.

6. Ky udhëzim do të zbatohet pa cenuar dispozitat përkatëse të ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners” sh.p.k., për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij udhëzimi:

1. “Aeroport” nënkupton çdo sipërfaqe toke e përshtatur në mënyrë specifike për ulje, ngritje dhe manovrimin e avionëve, duke përfshirë instalimet ndihmëse të nevojshme për këto operime, në varësi të kërkesave të trafikut ajror dhe të shërbimeve, duke përfshirë instalimet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet tregtare ajrore;

2. “Enti menaxhues i aeroportit” nënkupton një organ i cili, së bashku me aktivitetet e tjera ose jo, në përputhje me ligjet kombëtare, rregulloret apo kontratat në fuqi, ka si objektiv të tij administrimin dhe menaxhimin e aeroportit apo infrastrukturës së rrjetit të aeroporteve, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm, të pranishëm në

aeroportet apo rrjetet e aeroporteve në fjalë;

3. “Përdorues aeroportit” do të thotë çdo person fizik ose juridik përgjegjës për transportin e udhëtarëve, postës dhe/ose të mallrave nga ajri, për në ose nga aeroporti në fjalë;

4. “Tarifë aeroportit” nënkupton një tarifë të mbledhur në favor të entit menaxhues të aeroportit dhe që paguhet nga përdoruesit e aeroportit për përdorimin e faciliteteve dhe shërbimeve, të cilat sigurohen ekskluzivisht nga enti menaxhues i aeroportit dhe të cilat janë të lidhura me uljet, ngritjet, ndriçimin dhe parkimin e avionëve, si dhe me përpunimin e udhëtarëve dhe mallrave;

5. “Rrjeti i Aeroporteve” do të thotë një grup aeroportesh, i përcaktuar si i tillë sipas rregullave nga organi kompetent shtetëror dhe që operohet nga i njëjti ent menaxhues i aeroportit.

6. “Marrëveshje shumëpalëshe” është marrëveshja shumëpalëshe, shtojcat dhe protokolli I i saj, për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, “Për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Evropian”, në vijim referuar si marrëveshja shumëpalëshe.

7. “Komisioni” është komisioni *ad-hoc*, i ngritur me funksionet e autoritetit kombëtar të pavarur mbikëqyrës që do të sigurojë zbatimin korrekt të masave të marra në përputhje me këtë udhëzim.

Neni 3

Mosdiskriminimi

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që tarifën e aeroportit të mos jenë diskriminuese ndaj përdoruesve të aeroportit. Kjo nuk e pengon rregullimin e tarifave të aeroportit për çështje të interesit publik dhe të përgjithshëm, duke përfshirë çështjet e mjedisit. Kriteret e



përdorura për një rregullim të tillë duhet të jenë të përshtatshme, objektive dhe transparente.

Neni 4

Sistemet e përbashkëta të tarifave

Autoriteti i Aviacionit Civil mund të lejojë entin menaxhues të aeroportit, për të paraqitur një sistem të përbashkët dhe transparent tarifash në aeroportet që i shërbejnë së njëjtës hapësirë urbane, me kusht që çdo aeroport të përmbushë kërkesat për transparencë të përcaktuara në nenin 6.

Neni 5

Konsultimi dhe miratimi

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të hartojë një procedure të detyrueshme, që rregullon konsultimin ndërmjet entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit/përfaqësuesve të tyre ose shoqërive të përdoruesve të aeroportit, në lidhje me:

- a) aplikimin dhe funksionimin e sistemit të tarifave aeroportuale;
- b) nivelin e tarifave aeroportuale;
- c) cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Konsultimet do të zhvillohen të paktën një herë në vit, nëse nuk është rënë dakord ndryshe në konsultimin e fundit. Në rast se ekziston një marrëveshje shumëvjeçare ndërmjet entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit, konsultimet do të zhvillohen siç janë parashikuar në këtë marrëveshje.

Autoriteti i Aviacionit Civil ka të drejtë për të kërkuar konsultime më të shpeshta.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për të garantuar se, kurdo që të jetë e mundur, ndryshimet ose propozimet për ndryshime në sistemin apo nivelin e tarifave të aeroportit, të bëhen në marrëveshje mes entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit.

2.1 Enti menaxhues i aeroportit, çdo propozim për ndryshime në sistemin apo nivelin e tarifave të aeroportit, shoqëruar me arsyet përkatëse, do ta paraqesë te përdoruesit e aeroportit, jo më vonë se katër muaj, para se ato të hyjnë në fuqi, përveçse kur ka rrethana të jashtëzakonshme, të cilat duhet të justifikohen për përdoruesit e aeroportit.

2.2 Enti menaxhues i aeroportit, do të kryejë konsultime me përdoruesit e aeroportit dhe do të marrë parasysh pikëpamjet e tyre mbi ndryshimet e propozuara, para se të merret një vendim.

2.3 Enti menaxhues i aeroportit normalisht do të publikojë vendimin e tij ose rekomandimin jo më vonë se dy muaj përpara hyrjes së tij në fuqi. Enti menaxhues i aeroportit do të justifikojë vendimin e tij në lidhje me pikëpamjet e përdoruesve të aeroportit, në rast se nuk është arritur një marrëveshje mes entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit, mbi ndryshimet e propozuara.

2.4 Enti menaxhues i aeroportit publikon vendimin përfundimtar, pas miratimit nga ministri përgjegjës për transportin.

3. Në rast të një mosmarrëveshjeje, mbi një vendim të marrë nga enti menaxhues i aeroportit, mbi tarifat e aeroportit, sipas pikës 2.3, secila palë (enti menaxhues i aeroportit dhe përdoruesit e aeroportit) mund të kërkojë ndërhyrjen e Komisionit, siç përcaktohet në nenin 10, i cili do të shqyrtojë arsyet e argumentuara për modifikimin e sistemit apo nivelit të tarifave të aeroportit.

4. Kur enti menaxhues i aeroportit ka marrë një vendim për modifikimin e sistemit apo nivelit të tarifave të aeroportit dhe ky vendim është paraqitur për shqyrtim pranë Komisionit, ky vendim nuk do të ketë efekt deri sa komisioni ta ketë shqyrtuar çështjen.

Komisioni, brenda katër javëve nga dita që çështja është sjellë para tij, do të marrë një vendim të përkohshëm për hyrjen në fuqi të ndryshimit të tarifave të aeroportit, përveçse kur vendimi përfundimtar mund të merret brenda të njëjtit afat. Vendimi në çdo rast duhet të jetë në përputhje me pikën 6, të nenit 1, të këtij udhëzimi.

Neni 6

Transparenca

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që enti menaxhues i aeroportit i garanton çdo përdoruesi të aeroportit ose përfaqësuesve apo shoqatave të përdoruesve të aeroportit, se konsultimet e herëpashershme, siç përcaktohen në nenin 5 (1), do të përmbajnë informacion për komponentët që shërbejnë si bazë për përcaktimin e sistemit apo nivelit të të gjitha tarifave të mbledhura nga enti menaxhues i aeroportit.

Informacioni duhet të përfshijë të paktën:

a) një listë të shërbimeve të ndryshme dhe të infrastrukturës, të ofruar në këmbim të tarifës së mbledhur nga aeroporti;



b) metodologjia e përdorur për përcaktimin e tarifave të aeroportit;

c) struktura e përgjithshme e kostos në lidhje me facilitetet dhe shërbimet me të cilat lidhen tarifat e aeroportit;

ç) të ardhurat e tarifave të ndryshme dhe kostoja totale e shërbimeve të mbuluara nga to;

d) çdo financim nga autoritetet publike të faciliteteve dhe të shërbimeve me të cilat lidhen tarifat e aeroportit;

e) parashikimet e situatës në aeroport për sa u përket tarifave, rritjes së trafikut dhe investimeve të propozuara;

f) përdorimi aktual i infrastrukturës së aeroportit dhe i pajisjeve gjatë një periudhe të caktuar; dhe

g) rezultati parashikuar i çdo investimi të madh, të propozuar, në aspektin e efekteve të tyre në kapacitetin e aeroportit.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që përdoruesit e aeroportit të paraqesin informacion për entin menaxhues të aeroportit para çdo konsultimi, siç parashikohet në nenin 5 (1), të lidhur në veçanti me:

a) parashikimet për sa i përket trafikut;

b) parashikimet për sa i përket përbërjes dhe programimit të përdorimit të flotës së tyre;

c) planet e tyre të zhvillimit, në aeroportin në fjalë; dhe

ç) kërkesat e tyre në aeroportin në fjalë.

3. Në përputhje me legjislacionin përkatës, informacionet e dhëna në bazë të këtij neni do të konsiderohen si konfidencial ose ekonomikisht të ndjeshëm dhe do të trajtohen në përputhje me rrethanat. Në rastin e enteve menaxhuese të aeroporteve, që janë të kuotuar në tregun e bursës, do të jetë në përputhje dhe me rregullat për tregun e aksioneve.

Neni 7

Infrastruktura e re

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për të siguruar që enti menaxhues i aeroportit konsultohet me përdoruesit e aeroportit para se të finalizohen planet për projekte të reja infrastrukturore.

Neni 8

Standardet e cilësisë

1. Enti menaxhues i aeroportit dhe përfaqësuesit ose shoqatat e përdoruesve të aeroportit në

aeroport, do të hyjnë në negociata për të arritur një marrëveshje mbi nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruar në aeroport.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbikëqyrë ecurinë e negociatave deri në arritjen e marrëveshjes, të cilat mund të zhvillohen edhe si pjesë e konsultimeve të përcaktuara në nenin 5 (1).

3. Çdo marrëveshje përcakton nivelin e shërbimit që do të ofrohet nga enti menaxhues i aeroportit, duke marrë në konsideratë sistemin ose nivelin aktual të tarifave të aeroportit dhe nivelin e shërbimit në këmbim të këtyre tarifave, që do të paguajnë përdoruesit e aeroportit.

Neni 9

Diferencimi i shërbimeve

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për të garantuar se Enti menaxhues i aeroportit mund të ndryshojë cilësinë dhe gamën e shërbimeve të veçanta të aeroportit, terminaleve apo pjesëve të terminaleve, me qëllim ofrimin e shërbimeve të përshtatura apo një terminali të dedikuar, apo për një pjesë të terminalit.

2. Niveli i tarifave të aeroportit, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të diferencohet në bazë të cilësisë, qëllimit dhe gamës të këtyre shërbimeve ose ndonjë objektivi tjetër të arsyetuar dhe transparent. Pa rënë ndesh me nenin 3, Enti menaxhues i aeroportit mund të vendosë tarifa të tilla të diferencuara.

3. Enti menaxhues i aeroportit duhet të dorëzojë propozimin e tarifave të diferencuara pranë AAC-së.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të lejojë çdo përdorues aeroporti që dëshiron të përdorë shërbime të përshtatura për një terminal të dedikuar ose një pjesë të terminalit, që të ketë akses në këto shërbime.

4. Në rast se më shumë përdorues të aeroportit, se sa është e mundur për shkak të kufizimeve të kapaciteteve, dëshirojnë të kenë akses në shërbime të përshtatura dhe/ose një terminal të dedikuar ose në një pjesë të terminalit, aksesit do të përcaktohet në bazë të kriterëve përkatës, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Këto kriterë përcaktohen nga Enti menaxhues i aeroportit dhe miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.



Neni 10

Autoritet i pavarur mbikëqyrës

1. Për zbatimin korrekt të masave të marra në përputhje me këtë udhëzim dhe, në veçanti, të detyrave të përcaktuara në nenin 6, ministri përgjegjës për transportin, me urdhër të veçantë, ngre komisionin *ad-hoc*, me funksionet e autoritetit të pavarur mbikëqyrës. Përbërja e komisionit është me përfaqësues nga strukturat e politikave të transportit ajror dhe autoritetit të aviacionit civil.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij neni, është i pavarur nga çdo ent menaxhues i aeroportit dhe transportues ajror. Komisioni ushtron kompetencat e tij në mënyrë të paanshme dhe transparente.

3. Sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, Komiteti i Përbashkët i saj do të njoftohet për adresën e Komisionit, detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara, si dhe për masat e marra për të siguruar përputhjen me paragrafin 2 të këtij neni.

4. Komisioni do të sigurojë, në lidhje me mosmarrëveshjet e referuara në nenin 5 (3), se janë marrë masa:

a) Për të krijuar një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit;

b) Për të përcaktuar kushtet sipas të cilave një mosmarrëveshje mund të paraqitet për shqyrtim pranë Komisionit. Komisioni, në veçanti, nuk do të trajtojë ankesat, të cilat i konsideron si të pajustificuara siç duhet ose të padokumentuara në mënyrën e duhur; dhe

c) Të përcaktojë kriteret sipas të cilave mosmarrëveshjet do të vlerësohen për zgjidhje.

Këto procedura, kushtet dhe kriteret duhet të jenë jodiskriminuese, transparente dhe objektive.

5. Kur ndërmerret një hetim për arsyetimin për ndryshimin e sistemit ose të nivelit të tarifave të aeroportit, të vendosura siç përcaktohet në nenin 5, Komisioni do të ketë akses në informacionin e nevojshëm nga palët e interesuara dhe duhet të kërkojë që të konsultohet me palët e interesuara, në mënyrë që të marrë vendimin e tij. Pa rënë ndesh me nenin 5 (4), Komisioni do të nxjerrë një vendim përfundimtar, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast brenda katër muajve që çështja është sjellë përpara tij. Kjo periudhë mund të zgjatet edhe dy muaj, në raste të jashtëzakonshme dhe të

justifikuara drejtë. Vendimet e Komisionit do të kenë efekt detyrues, pa paragjykuar ndonjë shqyrtim gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi.

6. Komisioni do të publikojë një raport vjetor lidhur me aktivitetet e tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

UDHËZIM**Nr. 1545, datë 29.3.2016****SHITBLERJA E MJETEVE RRUGORE
ME MOTOR DHE/OSE E
RIMORKIOVE, TË REJA OSE TË
PËRDORURA, TË AUTORIZUARA NGA
PRODHUESI**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar;

Për t’iu përgjigjur kërkesave në rritje të sigurisë së qarkullimit rrugor dhe vendosjes së standardeve për veprimtaritë e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Neni 1

Subjektet juridike, për të marrë licencën e veprimtarisë “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura”, me kodin VII.3.B.2, në Qendrën



Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit, dhe për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, duhet të disponojnë pajisjet, instrumentet, ambientet e nevojshme, si dhe duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Neni 2

VII.3.B.2 Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi

1. Subjektet juridike, që të ushtrorjnë veprimtarinë e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTE

a) Gropë riparimi 1 (një) copë, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus, ose pajisje ngritëse (mekanike, hidraulike ose elektrike) 1 (një) copë, sipas standardeve teknike;

b) Elektrokompresor, 1 (një) copë;

c) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit nga 1 (një) copë;

d) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergjençës së gomave, nga 1 (një) copë;

e) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave, 2 (dy) copë;

f) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave, nga 1 (një) copë;

g) Kompjuterë 4 (katër) copë;

h) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 4 (katër) copë;

i) Kuti të ndihmës së shpejtë 2 (dy) copë;

j) Llamba portative me transformator 220/24–36 volt, 4 (katër) copë;

k) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të punës së motorit, 1 (një) copë;

l) Vegla matëse dhe të kontrollit, për profesionin motorist, xhenerik, elektroauto etj., nga 2 (dy) seri;

m) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave 1 (një) copë;

n) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave, 2 (dy) copë etj.;

o) Kazan për grumbullimin e mbeturinave, 2 (dy) copë;

p) Fuçi 1 (një) copë ose bidonë 20 litra, 5 (pesë) copë, për grumbullimin e vajrave.

AMBIENTE

a) Vend qëndrimi për mjetet që do të shiten, me sipërfaqe jo më pak se 100 (njëqind) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë 4 (katër) autovetura ose sipas rastit 2 (dy) kamionë/autobusë;

b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, me sipërfaqe jo më pak se 50 (pesëdhjetë) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë 2 (dy) autovetura ose sipas rastit 1 (një) kamion/autobus;

c) Zyrë për punë administrative;

d) Nyjë hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, kodi VII.3.B.2, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të reja dhe/ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, ku të përcaktohen, emri i subjektit, emri i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve



rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrat për shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, VII.3.B.2 - Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vlefës së garancisë financiare.

g) Kontratë me prodhuesin, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit, për shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove të tyre, të reja dhe/ose të përdorura, të legalizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

1. Përpara marrjes së licencës së veprimtarisë, subjektet duhet të ngurtësojnë dhe të dorëzojnë në Qendrën Kombëtare të Licencimit, vlerën e garancisë prej 200.000 (dyqind mijë) lekësh, për veprimtarinë “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura”, të autorizuar nga prodhuesi, me kodin VII.3.B.2.

Neni 4

1. Përgjegjësi teknik, për të marrë dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

VII.3.B.2 Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të reja dhe/ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

c) Përgatitjen teknike-profesionale për veprimtarinë e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre;

d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 5

1. Modelet e regjistrave për veprimtari autoriparimi, me kodin VII.3.B.2, janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Plotësimi i regjistrave duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.

3. Çdo shitblerje të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, do të shoqërohet me garanci.

4. Ruajtja e regjistrave në arkiv, duhet të bëhet sipas rregullave të arkivit.

Neni 6

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi për ngritjen e nivelit teknik-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari shitblerje të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të reja dhe/ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, me kodin VII.3.B.2, sipas programeve të përgatitura prej saj, bazuar dhe në njohuritë e domosdoshme të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Përgjegjësi teknik, për t’u pajisur me “Dëshmi aftësie profesionale”, duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

a) Kërkesë për pajisje me “Dëshmi aftësie profesionale”, ku të përcaktohen veprimtaria për shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të reja dhe/ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, si dhe veprimtaria e tij e kryer, nga marrja e diplomës në formën e CV-së;

b) Kopje të noterizuar të diplomës;

c) Kopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përkrahur si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së seksionit përkatës etj.;

e) Vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura.



dura në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006.

3. Përgjegjësi teknik pajiset me “Dëshmi aftësie profesionale” nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi komisioni të ketë dhënë rezultat pozitiv për provimin, mbi nivelin e njohurive të përgjegjësve teknik për shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Pyetjet dhe tezat e provimit përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Përbërja e komisionit të provimit të nivelit të njohurive të përgjegjësve teknik për pajisje me “Dëshmi aftësie profesionale” përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Komisioni

duhet të përbëhet nga punonjës të ministrisë përgjegjëse për transportin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 7

1. Udhëzimi nr. 9, datë 3.7.2007, “Për ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre, të autorizuar nga prodhuesi”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



MODELI I REGJISTRIT PËR SHITBLERJEN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE/OSE E RIMORKIOVE TË REJA OSE TË PËRDORURA

VII.3.B.2 Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuara nga prodhuesi

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e furnitorit			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për origjinën dhe dokumentet e qarkullimit	Gjeneralitet e blerësit të autorizuar			Garancia	Data e shitjes ose heqjes
		Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma					Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma		

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.
Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim.
Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.



UDHËZIM

Nr. 1546, datë 29.3.2016

**AUTORIPARIMI I MJETEVE RRUGORE
ME MOTOR DHE RIMORKIOVE**

Në mbështetje të: pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar;

Për t’iu përgjigjur kërkesave në rritje të sigurisë së qarkullimit rrugor dhe vendosjes së standardeve për veprimtaritë e: autoriparimit; shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre; mbledhjes, depozitimit dhe shkatërrimit të mjeteve dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura etj., ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Neni 1

Subjektet juridike, për të marrë licencë për veprimtaritë “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit dhe për të ushtruar veprimtaritë e autoriparimit, në një ose në disa nga specifikimet e përcaktuara në të, duhet të disponojnë pajisjet, instrumentet, ambientet e nevojshme, si dhe të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas nenit ose neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Neni 2

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve

rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTE

a) Gropë riparimi 1 (një), ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus, ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike) 1 (një) copë, sipas standardeve teknike;

b) Elektrokompresor 1 (një) copë;

c) Kompjuter 1 (një) copë;

d) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;

e) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;

f) Llamba portative me transformator 220/24–36 volt 2 (dy) copë;

g) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit 1 (një) copë;

h) Vegla matëse dhe të kontrollit nga 1 (një) seri, për profesionin motorist, xhenerik etj.;

i) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë;

j) Fuçi për grumbullimin e vajrave të përdorura 1 (një) copë.

AMBIENTE

a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo më pak se 30 (tridhjetë) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë 1 (një) autoveturë ose sipas rastit 1 (një) kamion/autobus;

b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojnë 1 (një) autoveturë ose sipas rastit 1 (një) kamion/autobus;

c) Zyrë për punë administrative;

d) Nyjë hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/a, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, emri i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin, sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;



- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/a - Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vlefës së garancisë financiare.

Neni 3

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTE

a) Gropë riparimi 1 (një) copë, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus, ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), 1 (një) copë, sipas standardeve teknike;

b) Elektrokompresor 1 (një) copë;

c) Kompjuter (1 (një) copë;

d) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;

e) Kutë të ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;

f) Llamba portative me transformator 220/24–36 volt 2 (dy) copë;

g) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë.

AMBIENTE

a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo më pak se 30 (tridhjetë) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose një kamion/autobus;

b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus;

c) Zyrë për punë administrative;

d) Nyjë hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes të karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodë VII.3.B.1/b, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve



rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/b - Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vlefës së garancisë financiare.

Neni 4

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTE

a) Pajisje ngritëse (mekanike, hidraulike ose elektrike) 1 (një) copë, sipas standardeve teknike;

b) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit 1 (një) copë;

c) Kompjuter 1 (një) copë;

d) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;

e) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;

f) Llamba portative me transformator 220/24–36 volt 2 (dy) copë;

g) Vegla matëse e të kontrollit 1 (një) seri, për profesionin elektroauto etj.;

h) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë.

AMBIENTE

a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo më pak se 30 (tridhjetë) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus;

b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus;

c) Zyrë për punë administrative;

d) Nyjë hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për

ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/c, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/c - Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vlefës së garancisë financiare.



Neni 5

VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTE

- a) Ngritës (mekanik, hidraulik ose elektrik) 1 (një) copë, sipas standardeve teknike;
- b) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergencës së gomave 1 (një) copë;
- c) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave 1 (një) copë;
- d) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave 1 (një) copë;
- e) Elektrokompresor 1 (një) copë;
- f) Kompjuter 1 (një) copë;
- g) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 1 (një) copë;
- h) Kutë të ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;
- i) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave 1 (një) copë;
- j) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave 1 (një) seri etj.;
- k) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë;

AMBIENTE

a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo më pak se 30 (tridhjetë) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose një kamion/autobus;

b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion/autobus;

- c) Zyrë për punë administrative;
- d) Një hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/ç, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas forma-

tit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;
- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/ç - Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vlefës së garancisë financiare.

Neni 6

VII.3.B.1/d Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE

- a) Kompjuterë 2 (dy) copë;
- b) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- c) Kutë të ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;



d) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë;
AMBIENTE

a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur për ekspozimin e mjeteve motorike ose rimorkiove, me sipërfaqe jo më pak se 50 (pesëdhjetë) metra katrorë, ku mund të qëndrojnë 3 (tri) autovetura ose sipas rastit 2 (dy) kamionë/autobusë;

b) Zyrë për punë administrative;

c) Nyjë hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodit VII.3.B.1/d, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për blerjen dhe shitjen, e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove,

Faqe| 3382

VII.3.B.1/d – Blerja, shitja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vlefës së garancisë financiare.

Neni 7

VII.3.B.1/dh Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTE

a) Pajisje për presimin e pjesëve të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, të dala jashtë përdorimit 1 (një) copë;

b) Kompjuterë 2 (dy) copë;

c) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;

d) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;

e) Vegla dhe çelësa të ndryshëm, për zmontime mjeteshe, 2 (dy) seri etj.;

f) Kazan për mbeturinat 2 (dy) copë;

g) Fuçi 1 (një) copë apo bidonë 10 litra 5 (pesë) copë, për grumbullimin e vajrave të përdorura.

AMBIENTE

a) Sipërfaqe për: depozitimin e mjeteve që do të shkatërrohen, me sipërfaqe jo më pak se 100 (njëqind) metra katrorë ku mund të qëndrojnë 4 (katër) autovetura ose sipas rastit 2 (dy) kamion/autobus, sipërfaqe për pjesët e ndërtimit të dala jashtë përdorimit etj.;

b) Zyrë për punë administrative;

c) Nyjë hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, kodit VII.3.B.1/dh, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë:

a) Kërkesë nga drejtuesi ligjor për pajisjen me licencë veprimtarie për mbledhjen, depozitimin, shkatërrimin, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, ku të përcaktohen,



emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet, instrumentet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/dh – Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;

f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 8

1. Përpara marrjes së licencës së veprimtarisë, subjektet duhet të ngurtësojnë dhe të dorëzojnë në Qendrën Kombëtare të Licencimit, vlerën e garancisë prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh, për çdo nënkategori (“a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”) të veprimtarive të autoriparimit me kodin VII.3.B.1.

Neni 9

1. Përgjegjësi teknik, për të marrë dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

c) Përgatitjen teknike-profesionale për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

c) Përgatitjen teknike-profesionale për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;



c) Përgatitjen teknike-profesionale për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve elektrike, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

c) Përgatitjen teknike-profesionale për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/d Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

c) Përgatitjen teknike-profesionale, për veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, dhe të pjesëve të ndërtimit të tyre;

d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/dh Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 102;

c) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 252;

d) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

e) Përgatitjen teknike-profesionale për veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura;

f) Rregullat e sigurimit teknik në punë;

g) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 10

1. Modelet e regjistrave për çdo veprimtari autoriparimi, me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Plotësimi i regjistrave, duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.

3. Çdo ndërhyrje në riparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, do të shoqërohet me garanci.

4. Ruajtja e regjistrave në arkiv, duhet të bëhet sipas rregullave të arkivit.

Neni 11

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi për ngritjen e nivelit teknik-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi, me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, sipas programeve të përgatitura prej saj, bazuar dhe në njohuritë e domosdoshme të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Përgjegjësi teknik, për t'u pajisur me “Dëshmi aftësie profesionale”, duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

a) Kërkesë për pajisje me “Dëshmi aftësie profesionale”, ku të përcaktohen, nënkategoria ku do të aplikojë dhe veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës në formën e CV-së;

b) Kopje të noterizuar të diplomës;

c) Kopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacion teknik justifikues (original ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo



specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së seksionit përkatës etj.;

e) Vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006.

3. Përgjegjësi teknik pajiset me “Dëshmi aftësie profesionale” nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi komisioni të ketë dhënë rezultat pozitiv për provimin, mbi nivelin e njohurive të përgjegjësve teknikë, sipas nënkategorive ku kërkon aplikanti, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Pyetjet dhe tezat e provimit përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Përbërja e komisionit të provimit të nivelit të njohurive të përgjegjësve teknik për pajisje me “Dëshmi aftësie profesionale” përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Komisioni duhet të përbëhet nga punonjës të ministrisë përgjegjëse për transportin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 12

Udhëzimi nr. 8, datë 3.7.2007, “Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit sipas seksioneve”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

[illegible]

[illegible]

Page | 3387

[illegible]

Shënim. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.



MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE E RIMORKIOVE
VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia e punimeve	Data e dorëzimit
		Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma					Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma		

Shënim. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.



MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/d Blerja, shitja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia e punimeve	Data e dorëzimit
		Emri, mbiemri	Nr. i identifikimi	Firma					Emri, mbiemri	Nr. i identifikimi	Firma		

Shënim. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim.

Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.



MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE
VII.3.B.1/dh Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për elementet e rishfrytëzueshme	Elementet e rishfrytëzueshme të shitura	Elementet e papërdorura për riciklim	Metoda e trajtimit	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Data e dorëzimit
		Emri, mbiemri	Nr. i identifikimi	Firma								Emri, mbiemri	Nr. i identifikimi	Firma	

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

**UDHËZIM****Nr. 1547, datë 29.3.2016****AGJENCITË QË TRAJTOJNË PRAKTIKAT
E QARKULLIMIT TË MJETEVE
RRUGORE ME MOTOR DHE/OSE TË
RIMORKIOVE**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar;

Për t’iu përgjigjur kërkesave në rritje të trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove etj., ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:**Neni 1**

Subjektet juridike, për të marrë licencën e veprimtarisë “Agjenci që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4, në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit dhe për të ushtruar veprimtarinë e agjencisë që trajton praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, duhet të disponojnë ambientet e nevojshme, si dhe duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas nenit ose neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Neni 2**VII.3.B.4 Agjenci që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove**

1. Subjektet juridike, që të ushtrorjnë veprimtarinë e agjencisë që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, duhet të disponojnë:

a) Zyrë për punë administrative, me sipërfaqe jo më pak se 20 (njëzet) metra katrorë;

b) Nyjë hidrosanitare;

c) Kompjuterë 2 (dy) copë;

d) Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri 1 (një) copë.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, kodin VII.3.B.4, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për agjencisë që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, emri i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të vërtetimit të aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”;

- zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”;

- zbatimin e udhëzimit “Agjencitë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor



dhe/ose të rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për agjenci që trajtojnë praktikatat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, VII.3.B.1/a - Agjenci që trajtojnë praktikatat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 3

1. Përgjegjësi teknik, për të marrë vërtetim të aftësisë profesionale” për agjenci që trajtojnë praktikatat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme, mbi:

VII.3.B.4 Agjenci që trajtojnë praktikatat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”;

c) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 252;

d) Udhëzimin “Agjencitë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

e) Udhëzimin “Për regjistrimin e mjeteve rrugore”, të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

Neni 4

1. Modelet e regjistrave për çdo veprimtari të agjencive për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, me kodin VII.3.B.4, janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Plotësimi i regjistrave, duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.

3. Ruajtja e regjistrave në arkiv, duhet të bëhet sipas rregullave të arkivit.

Neni 5

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi për

ngritjen e nivelit teknik-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtarinë e agjencisë për trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove, me kodin VII.3.B.4, sipas programeve të përgatitura prej saj, bazuar dhe në njohuritë e domosdoshme të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Përgjegjësi teknik, për t’u pajisur me “Vërtetim aftësie profesionale”, duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

a) Kërkesë për pajisje me “Vërtetim aftësie profesionale”, ku të përcaktohen, nënkategoria ku do të aplikojë dhe veprimtaria e tij e kryer, nga marrja e diplomës në formën e CV-së;

b) Kopje të noterizuar të diplomës;

c) Kopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së seksionit përkatës etj.;

e) Vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2, të nenit 3, të ligjit 9573, datë 3.7.2006.

3. Përgjegjësi teknik pajiset me “Vërtetim aftësie profesionale” nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi komisioni të ketë dhënë rezultat pozitiv për provimin, mbi nivelin e njohurive të përgjegjësve teknikë, sipas nënkategorive ku kërkon aplikanti, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Pyetjet dhe tezat e provimit përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Përbërja e komisionit të provimit të nivelit të njohurive të përgjegjësve teknik për pajisje me “Vërtetim aftësie profesionale” përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Komisioni duhet të përbëhet nga punonjës të ministrisë përgjegjëse për transportin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.



Neni 6

Udhëzimi nr. 10, datë 3.7.2007, “Për kriteret e licencimit të agjencive, për ushtrimin e veprimtarisë së trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



MODELI I REGJISTRIT PËR AGJENCI QË TRAJTOJNË PRAKTIKAT E QARKULLIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE/OSE TË RIMORKIOVE

VII.3.B.4 Agjenci që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove

Nr.	Data e fillimit të shërbimit	Të dhënat e klientit			Tipi i mjetit	Targa e mjetit	Lloji i shërbimit	Veprime lidhur me shërbimin	Data e mbarimit të shërbimit
		Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma					

Shënim. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.



UDHËZIM

Nr. 1548, datë 29.3.2016

TREGTIMI I PJESËVE TË KËMBIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE/OSE TË RIMORKIOVE

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar;

Për t’iu përgjigjur kërkesave në rritje të sigurisë së qarkullimit rrugor dhe vendosjes së standardeve për veprimtaritë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre etj., ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

Neni 1

Subjektet juridike, për të marrë licencën e veprimtarisë “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.3./a, b, në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit dhe për të ushtruar veprimtarinë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, duhet të disponojnë pajisjet dhe ambientet e nevojshme, si dhe duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas nenit ose neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Neni 2

VII.3.B.3/a Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE

- a) Kompjuterë 2 (dy) copë;
- b) Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- c) Kutinë e ndihmës së shpejtë 1 (një) copë.

AMBIENTE

a) Ambiente me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur për ekspozimin dhe magazinimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, me sipërfaqe jo më pak se 50 (pesëdhjetë) metra katrorë;

- b) Zyrë për punë administrative;
- c) Nyjë hidrosanitare;

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, kodin VII.3.B.3/a, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për tregtimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;
- informacion në lidhje me pajisjet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;



- zbatimin e udhëzimit “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për tregtimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, VII.3.B.3/a - Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 3

VII.3.B.3/b Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të autorizuar nga prodhuesi

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të autorizuar nga prodhuesi, duhet të disponojnë:

PAJISJE

a) Kompjuterë 2 (dy) copë;

b) Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;

c) Kutë të ndihmës së shpejtë 1 (një) copë.

AMBIENTE

a) Ambiente me sipërfaqe të mbyllura, me ndriçimin e duhur për ekspozimin dhe magazinimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve motorike dhe/ose rimorkiove, me sipërfaqe jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) metra katrorë;

b) Zyrë për punë administrative;

c) Një hidrosanitare.

2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, kodin VII.3.B.3/b, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:

a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për tregtimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të autorizuar nga prodhuesi, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetëdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, për:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;

- dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë etj.;

- informacion në lidhje me pajisjet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;

b) Kopje të dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;

c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;

d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet etj.;

e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- zbatimin e ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- zbatimin e udhëzimit “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

- plotësimin e regjistrit për tregtimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, VII.3.B.3/b - Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, të autorizuar nga prodhuesi;

- zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;

- zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri.

f) Kontratë me prodhuesin, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit, për tregtimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të legalizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

1. Përgjegjësi teknik për të marrë dëshminë e aftësisë profesionale, për veprimtarinë “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.3./a, b, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

a) Ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

b) Udhëzimin “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;



- c) Përgatitjen teknike-profesionale, për veprimtarinë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove;
- d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 5

1. Modelet e regjistrave për veprimtarin e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, me kodin VII.3.B.3/a, b, janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Plotësimi i regjistrave duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.

3. Çdo shitblerje e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove do të shoqërohet me garanci.

4. Ruajtja e regjistrave në arkiv, duhet të bëhet sipas rregullave të arkivit.

Neni 6

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi për ngritjen e nivelit teknik-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari tregtimin e pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, me kodin VII.3.B.3/a, b, sipas programeve të përgatitura prej saj, bazuar dhe në njohuritë e domosdoshme të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Përgjegjësi teknik për t'u pajisur me “Dëshmi aftësie profesionale” duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

a) Kërkesë për pajisje me “Dëshmi aftësie profesionale”, ku të përcaktohen, nënkategoria ku do të aplikojë dhe veprimtaria e tij e kryer, nga marrja e diplomës në formën e CV-së;

b) Kopje të noterizuar të diplomës;

c) Kopje të kartës së identitetit;

d) Dokumentacion teknik justifikues (original ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së seksionit përkatës etj.;

e) Vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006.

3. Përgjegjësi teknik pajiset me “Dëshmi aftësie profesionale” nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi komisioni të ketë dhënë rezultat pozitiv për provimin, mbi nivelin e njohurive të përgjegjësve teknik, sipas nënkategorive ku kërkon aplikanti, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Pyetjet dhe tezat e provimit përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Përbërja e komisionit të provimit të nivelit të njohurive të përgjegjësve teknikë për pajisje me “Dëshmi aftësie profesionale” përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Komisioni duhet të përbëhet nga punonjës të ministrisë përgjegjëse për transportin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



MODELI I REGJISTRIT PËR TREGTIMIN E Pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe /ose të rimorkiove
VII.3.B.3/a Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe /ose të rimorkiove

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e furnitorit			Pjesa e këmbimit	Të dhëna për origjinën	Të dhëna të tjera	Gjeneralitet e blerësit të autorizuar			Garancia	Data e shitjes ose heqjes
		Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma				Emri Mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma		

Shënim. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.



MODELI I REGJISTRIT PËR TREGTIMIN E Pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe /ose të rimorkiove
VII.3.B.3/b Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe /ose të rimorkiove, të autorizuara nga prodhuesi

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e furnitorit			Pjesa e këmbimit	Të dhëna për origjinën	Të dhëna të tjera	Gjeneralitet e blerësit të autorizuar			Garancia	Data e shitjes ose heqjes
		Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma				Emri, mbiemri	Nr. i identifikimit	Firma		

Shënim. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

**URDHËR****Nr. 182, datë 17.3.2016****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PARAQITJEN E VLERAVE
USHQIMORE DHE SHËNDETËSORE TË
PRODUKTEVE USHQIMORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 37 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për paraqitjen e vlerave ushqimore dhe shëndetësore të produkteve ushqimore”, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti**

RREGULLORE**PËR PARAQITJEN E VLERAVE
USHQIMORE DHE SHËNDETËSORE TË
PRODUKTEVE USHQIMORE²****KREU I****LËNDA, FUSHA E PËRDORIMIT DHE
PËRKUFIZIMET****Neni 1****Lënda dhe fusha e përdorimit**

1. Kjo rregullore plotëson legjislacionin shqiptar në lidhje me paraqitjen e vlerave ushqimore dhe

shëndetësore, me qëllim që të sigurohet funksionimi me efektivitet i tregut të brendshëm dhe një nivel i lartë i mbrojtjes së konsumatorit.

2. Kjo rregullore do të zbatohet për deklarimet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore të bëra gjatë marrëdhënieve tregtare, për etiketimin, prezantimin ose reklamimin e ushqimeve që shpërndahen si të tilla te konsumatori i fundit.

Në rastin e produkteve ushqimore jo të parapaketuara (duke përfshirë produkte të freskëta, të tilla si: fruta, perime ose bukë), të vendosura për shitje te konsumatori i fundit ose për furnizues me shumicë të produkteve ushqimore të paketuara në pikën e shitjes me kërkesën e blerësit ose parapaketuara me synimin për shitje të menjëhershme, neni 7 dhe neni 10 (2) (a) dhe (b) nuk do të zbatohen.

Kjo Rregullore do të zbatohet edhe për sa u përket ushqimeve të destinuara për furnizim për restorantet, spitalet, shkollat, mensat dhe për furnizues me shumicë (masivë) të ngjashëm.

3. Një markë tregtare, emër tregtar ose një emër i zgjedhur vetë (i fantazuar), i paraqitur në etiketimin, prezantimin ose reklamimin e produkteve ushqimore, i cili mund të jetë interpretuar si një deklarament vlerash ushqimore ose shëndetësore mund të përdoret, me kusht që të shoqërohet nga deklarimet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore përkatëse në etiketim, prezantim ose reklamim në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

4. Për përkrahje të përgjithshme (emërtime), të cilat kanë qenë përdorur tradicionalisht për të treguar një veçori të një kategorie ushqimesh apo pije, e cila nënkupton një efekt në shëndetin e njeriut, një shmangie nga paragrafi 3, i cili nuk ndryshon elementet thelbësore të kësaj Rregulloreje mund të miratohet me kërkesë të operatorëve të biznesit të ushqimit në fjalë në përputhje me legjislacionin evropian.

5. Kjo rregullore zbatohet pa rënë ndesh me dispozitat e mëposhtme:

a) Urdhrin nr. 568, datë 22.12.2008, “Për miratimin e rregullore “Për produktet ushqimore për përdorime ushqimore të veçanta””;

b) Urdhrin, nr. 266, datë 29.8.2011, “Për miratimin e rregullore “Mbi shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale””;

² Kjo rregullore është përafshuar pjesërisht me: rregulloren nr. 1924/2006, të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, e 20 dhjetorit 2006 (CELEX_02006R1924-20141213_EN_TX) “Mbi deklarimet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore të bëra në produktet ushqimore”, amenduar nga rregullorja (KE) nr. 107/2008, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 15 janar 2008, Rregullorja (KE) nr. 109/2008, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 janar 2008, Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 116/2010, e 9 shkurtit 2010, Rregullorja (EU) nr. 1169/2011, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2011, Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 1047/2012, e 8 nëntor 2012, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 404, datë 30.12.2006, faqe 9.



c) Urdhrin nr. 216, datë 23.5.2008, “Për miratimin e rregullores “Për ushqimet shtesë””.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje do të zbatohen:

a) Përkufizimet për “ushqimin”, “operatorin e biznesit ushqimor”, “vendosjen në treg” dhe “konsumatorin e fundit”, të përcaktuara në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”;

b) Përkufizimi i “ushqimeve shtesë”, i përcaktuar në urdhrin nr. 216, datë 23.5.2008, “Për miratimin e rregullores “Për ushqimet shtesë””;

c) Përkufizimet mbi “etiketimin”, “etiketimin e vlerave ushqimore”, “proteinave”, “karbohidrateve”, “sheqernave”, “yndyrave”, “yndyrave të ngopura”, “yndyrave me një lidhje të pangopur”, “yndyrave me shumë lidhje të pangopura” dhe “fibrave” të përcaktuara në VKM-në nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore””.

2. Në këtë rregullore do të aplikohen dhe përcaktimet e mëposhtme:

a) “Paraqitje” do të kuptojmë çdo mesazh ose deklaram (prezantim), i cili nuk është i detyrueshëm, duke përfshirë prezantimin në formë grafike, pikturë ose simbol në çdo formë, i cili thotë, sugjeron ose nënkupton që ushqimi ka karakteristika të veçanta;

b) “Vlerë ushqimore” do të kuptojmë proteina, karbohidrate, yndyra, fibra, Na, vitamina dhe minerale, të listuara në shtojcën VI të VKM-së nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore”” dhe substanca të cilat i përkasin ose janë komponentë të njërit nga këto kategori;

c) “Substancë tjetër” do të kuptojmë një substancë ndryshe nga substancat me vlerë ushqimore që kanë një ndikim ushqyes ose fiziologjik;

d) “Deklaratë ushqimore” do të kuptojmë çdo deklaratë e cila thotë, sugjeron ose nënkupton që produkti ka veti ushqyese të veçanta të dobishme në saje të:

i) energjisë (vlera kalorike e tij), që:

- siguron;
- siguron në shkallë rritëse ose zbritëse; ose
- nuk siguron; dhe/ose

ii) ushqyesve ose substancave të tjera, që:

- përmban;

- përmban në proporcione të zvogëluara ose të zmadhuara; ose

- nuk përmban;

e) “Deklarim shëndetësor” do të kuptojmë çdo deklaram që thotë, sugjeron ose nënkupton se ekziston një marrëdhënie midis një kategori ushqimi, një ushqimi ose një prej përbërësve të tij dhe shëndetit;

f) “Deklaratë për reduktimin e rrezikut të sëmundjes” do të kuptojmë çdo deklaratë shëndetësore që thotë, sugjeron ose nënkupton se konsumi i një kategorie të ushqimit, një ushqimi apo një prej përbërësve të tij në mënyrë të konsiderueshme zvogëlon një faktor rreziku në zhvillimin e një sëmundje të njeriut;

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Parime të përgjithshme për të gjitha deklaramet

Deklaramet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore mund të përdoren në etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e ushqimeve të vendosura në treg vetëm në qoftë se ato përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Pa mënjeluar kërkesat e përgjithshme për etiketimin e produkteve ushqimore, deklaramet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore, nuk duhet:

a) të jenë false, të gabuara ose që keqinformojnë konsumatorin;

b) të vënë në dyshim sigurinë dhe/ose përshtatshmërinë ushqyese të produkteve të tjera;

c) të stimulojnë ose pranojnë (lejojnë) konsumimin e tepërt të ushqimit;

d) të shprehin, të sugjerojnë ose të nënkuptojnë që një dietë e balancuar dhe e larmishme nuk mund të sigurojë sasi të nevojshme të ushqyesve në përgjithësi. Shmangiet në rastin e ushqyesve për të cilën sasi të mjaftueshme nuk mund të ofrohen nga një dietë e ekuilibruar dhe e larmishme, duke përfshirë kushtet për zbatimin e tyre dhe të dizajnuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj rregulloreje, duke e plotësuar atë, mund të miratohen në përputhje me procedurën rregullore me shqyrtim sipas legjislacionit evropian;



e) t'u referohet ndryshimeve në funksionet e organizmit, i cili mund të shkaktojë frikë te konsumatori drejtpërdrejt ose nëpërmjet paraqitjes grafike, simbolike apo ilustrimit me figura.

Neni 4

Kushtet e përgjithshme për përdorimin e deklarimeve të vlerave ushqimore dhe shëndetësore

1. Profili i lëndëve ushqyese për produktet ushqimore dhe/ose kategori të caktuara të tyre do të përcaktohet duke marrë parasysh:

a) Sasitë e ushqyesve të caktuar dhe substancave të tjera të përfshira në ushqim, si yndyrë, acide yndyrore të ngopura, acidet transyndyrore, sheqerna dhe kripë/natrium;

b) roli dhe rëndësia e ushqimit (ose e kategorive të ushqimit) dhe kontributi në dietën e popullsisë në përgjithësi ose, sipas rastit, i grupeve të caktuara të rrezikut, duke përfshirë fëmijët;

c) përbërja e përgjithshme e vlerave ushqyese në ushqim dhe prania e lëndëve ushqyese që janë njohur shkencërisht të kenë efekt mbi shëndetin.

Profili e lëndës ushqyese do të bazohet në njohuritë shkencore në lidhje me dietën dhe mënyrën e të ushqyerit, si dhe lidhjen e tyre me shëndetin.

Në përcaktimin e profilit të lëndës ushqyese, sipas legjislacionit evropian këshillat shkencorë sigurojnë, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë:

i) nëse përshkrimi është vendosur për ushqimin në përgjithësi dhe/ose kategori të ushqimit;

ii) në zgjedhjen dhe balancën e lëndëve ushqyese që duhet të merren në konsideratë;

iii) në zgjedhjen e referimit sasi/bazë për profilet;

iv) qasjen në llogaritjen e profileve; dhe

v) fizibilitetin dhe testimin e një sistemi të propozuar.

Profilet e lëndëve ushqyese dhe kushtet e tyre të përdorimit projektuar për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj rregulloreje duke e plotësuar atë, do të përditësohen duke marrë në konsideratë zhvillimet përkatëse shkencore duke u bazuar në përditësimet e bëra nga legjislacioni evropian.

2. Pa përjashtuar paragrafin 1, deklarimet e vlerave ushqyese:

a) duke iu referuar reduktimit të yndyrës, acideve të ngopura yndyrore, acidet transyndyrore,

sheqerna dhe kripë/natriumi, do të lejohen pa iu referuar një profili për lëndë ushqyese të veçanta, me kusht që ato të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore;

b) do të lejohen, kur vetëm një lëndë ushqyese e tejkalon përmbajtjen e lëndës ushqyese, me kusht që një deklaratë në lidhje me lëndën ushqyese specifike jepet në afërsi, në të njëjtën anë dhe me të njëjtën rëndësi si deklarimi. Kjo deklaratë do të lexohet si vijon “përmbajtje e lartë”.

3. Pijet që përmbajnë më shumë se 1,2% alkool ndaj volumit nuk do të japin deklarime shëndetësore.

Për pijet që përmbajnë më shumë se 1,2% alkool ndaj volumit do të lejohen, deklarimi i vlerave ushqimore që ka lidhje me deklarimet e vlerave ushqimore duke iu referuar nivelit të ulët të alkoolit ose reduktimit të përmbajtjes së alkoolit apo zvogëlimit të përmbajtjes së energjisë.

4. Masat përcaktuese për ushqimet apo kategori të ushqimeve të tjera nga ato të përmendura në paragrafin 3, për të cilat deklarimet e vlerave ushqimore ose shëndetësore janë të kufizuara ose të ndaluara dhe të dizajnuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj Rregulloreje mund të miratohen në përputhje me legjislacionin evropian dhe në dritën e provave shkencore.

Neni 5

Kushtet e përgjithshme

1. Përdorimi i deklarimit të vlerave ushqimore dhe shëndetësore do të lejohen vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) prania, mungesa ose përmbajtja e reduktuar e një ushqyesi ose substancave të tjera në ushqim ose kategori ushqimi në lidhje me të cilat është bërë deklarimi, ka treguar që ka ndikime të dobishme ushqyese ose fiziologjike, siç konfirmohet nga të dhënat shkencore të pranuar;

b) lënda ushqyese ose substancë tjetër për të cilat është bërë deklarimi:

i) përmbahet në produktin përfundimtar në një sasi të konsiderueshme, siç përcaktohet në legjislacionin evropian ose në rastet kur nuk ekzistojnë rregullore të tilla, në sasi të tillë që jep ndikim ushqyes ose fiziologjik të deklaruar, siç konfirmohet nga të dhënat shkencore të pranuar; ose

ii) nuk është ose është prezent në sasi të reduktuar që shkakton efektin fiziologjik ose



ushqyes të deklaruar, siç konfirmohet nga të dhënat shkencore të pranuara;

c) aty ku është e zbatueshme lënda ushqyese ose substancë tjetër për të cilën është bërë deklarimi, është në një formë të disponueshme për t'u përdorur nga organizmi;

d) sasia e produktit që pritet të konsumohet siguron sasi të konsiderueshme të lëndës ushqyese ose të substancës tjetër, për të cilat është bërë deklarimi, siç përcaktohet në legjislacionin evropian ose kur nuk ekziston (legjislacioni), sasi e konsiderueshme që shkakton efekt fiziologjik ose ushqyes të deklaruar konfirmohet nga të dhënat shkencore të pranuara;

e) përputhshmërinë me kushtet specifike, të vendosura (përcaktuara) në krerët III dhe IV të kësaj rregulloreje, sipas rastit.

2. Përdorimi i deklarimeve të vlerave ushqimore dhe shëndetësore lejohen vetëm atëherë kur pritet që mesatarja e konsumatorëve arrin të kuptojë efektet pozitive të këtyre deklarimeve.

3. Deklarimet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore do t'u referohen ushqimeve të gatshme për konsum në përputhje me instruksionet e prodhuesit.

Neni 6

Vërtetimi shkencor për deklarimet

1. Deklarimet e vlerave ushqimore dhe shëndetësore duhet të bazohen dhe vërtetohen nga të dhënat shkencore të pranuara.

2. Operatori i biznesit ushqimor që bën një deklarim ushqimor ose shëndetësor duhet të justifikojë përdorimin e këtij deklarimi.

Neni 7

Informacioni ushqimor

Etiketimi i vlerave ushqimore në produkte në të cilat është bërë deklarimi i vlerave ushqyese dhe/ose shëndetësore, është i detyrueshëm me përjashtim të reklamave të përgjithshme.

Informacioni i ofruar përbëhet nga ajo e specifikuar në nenin 22 (1) të rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore” mbi dhënien e informacionit të ushqimit për konsumatorët. Kur është bërë deklarimi i vlerës ushqimore dhe/ose shëndetësore për një lëndë ushqyese të përmendur në nenin 22 (3) të rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”, shuma e kësaj lënde ushqyese duhet të deklarohet në përputhje me Faqe|3404

nenet 23 dhe 24 të rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”.

Sasia/të e substancës/ave me të cilat lidhet një deklarim i vlerave ushqimore ose shëndetësore, por që nuk jepet në etiketimin e vlerave ushqimore duhet të vendoset në të njëjtën fushë pamje me informacionin ushqimor dhe duhet të shprehet në përputhje me nenet 23 dhe 24 të rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”. Njësia e matjes, e përdorur për të shprehur sasinë e substancës, do të jetë e përshtatshme për substancat individuale në fjalë.

Në rastet e shtesave ushqimore, informacioni ushqimor do të jepet në përputhje me pikat 15, 16 dhe 17, të urdhrit nr. 216, datë 23.5.2008, “Për miratimin e rregullave për ushqimet shtesë”.

KAPITULLI III

DEKLARIMET E VLERAVE USHQIMORE

Neni 8

Kushtet specifike

1. Deklarimet ushqimore do të lejohen vetëm nëse ato janë të shënuara në aneks dhe janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Ndryshimet në aneks do të bëhen në përputhje me ndryshimet e bëra në legjislacionin evropian.

Neni 9

Deklarimet krahasuese

1. Në lidhje me reklamat mashtruese dhe krahasuese, një krahasim mund të bëhet vetëm në mes të ushqimeve të së njëjtës kategori, duke marrë parasysh një sërë ushqimesh të asaj kategorie. Ndryshimi në sasinë e lëndës ushqyese dhe/ose vlerës së energjisë do të deklarohet dhe krahasimi bëhet për të njëjtën sasi ushqimi.

2. Deklarimet krahasuese të vlerave ushqimore do të krahasojnë përbërjen e ushqimit në fjalë me një sërë ushqimesh të së njëjtës kategori, të cilat nuk kanë një përbërje që u lejon atyre të mbajnë një deklarim, duke përfshirë ushqimet e markave të tjera.



KAPITULLI IV DEKLARIMET SHËNDETËSORE

Neni 10

Kushtet specifike

1. Deklarimet shëndetësore ndalohen në qoftë se ato nuk përputhen me kërkesat e përgjithshme të dhëna në kapitullin II dhe kërkesat specifike të këtij kapitulli dhe janë të autorizuar në përputhje me këtë rregullore dhe përfshihen në listën e deklarimeve të lejuara të dhëna në nenet 13 dhe 14 të kësaj Rregulloreje.

2. Deklarimet shëndetësore do të lejohen vetëm në qoftë se përfshihet në etiketë informacioni i mëposhtëm ose në qoftë se nuk ekzistojnë etiketa të tilla, në prezantimin dhe reklamimin:

a) e një formulimi që tregon rëndësinë e një diete të balancuar dhe të larmishme dhe të një jete të shëndetshme;

b) sasia e ushqimit dhe mënyra e duhur e përdorimit për të marrë efektet pozitive të këtyre deklarimeve;

c) kur është e përshtatshme duhet të jepet një informacion për personat për të cilët ky ushqim duhet mbajtur larg; dhe

d) një paralajmërim i duhur për produktet konsumimi i tepërt i të cilave përbën një rrezik për shëndetin.

3. Referenca të përgjithshme, për dobite jospesifike të një ushqyesi ose të ushqimit për një shëndet të mirë ose për një shëndet të lidhur me mirëqenien, mund të bëhen vetëm në qoftë se shoqërohet nga një deklaram shëndetësor specifik i përfshirë në listat e dhëna në nenet 13 dhe 14.

Neni 11

Shoqatat kombëtare të mjekësisë, ekspertët e të ushqyerit ose dietetikë dhe shoqata bamirëse të lidhura me shëndetin

Në mungesë të rregullave specifike në lidhje me rekomandimet apo mbështetje nga shoqatat kombëtare të mjekësisë, ekspertët e të ushqyerit apo profesionistët dietetikë dhe shoqatave bamirëse të lidhura me shëndetin, rregullat përkatëse kombëtare mund të zbatohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit evropian.

Neni 12

Kufizimet në përdorimin e disa deklarimeve shëndetësore

Deklarimet shëndetësore të mëposhtme nuk do të lejohen:

a) deklarimet që sugjerojnë që mos konsumimi i këtij ushqimi ndikon në shëndet;

b) deklarimet të cilat bëjnë referenca për normën ose sasinë e humbjes së peshës;

c) deklarimet të cilat bëjnë referenca për rekomandime të mjekëve të veçantë ose specialistë shëndeti ose shoqata të tjera jo të përmendura në nenin 11.

Neni 13

Deklarimet shëndetësore ndryshe nga ato që i referohen reduktimit të riskut të sëmundjes dhe për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve

1. Deklarimet shëndetësore që përshkruhen ose i referohen:

a) rolit të një ushqyesi ose substance tjetër në rritjen, zhvillimin dhe funksionet e trupit; ose

b) funksionit psikologjik dhe sjelljes; ose

c) pa cenuar urdhrin nr. 146, datë 2.12.2009, “Për miratimin e rregullores “Për ushqimet për përdorim në dieta me energji të kufizuar për ulje në peshë”, dobësimit ose kontrollit të peshës ose uljes së ndjenjës së oreksit ose rritjes së ndjenjës së ngopjes ose uljes së energjisë së mundshme nga dieta, mund të bëhen pa iu nënshtruar procedurës së miratimit sipas legjislacionit evropian, në qoftë se ato janë:

i) bazuar në të dhënat shkencore të pranuar; dhe

ii) janë të kuptueshme nga shumica e konsumatorëve,

sipas listës së nxjerrë nga Komisioni Evropian, e shoqëruar nga kushtet që zbatohen për to dhe duke u bazuar në arsyetimin përkatës shkencor.

Neni 14

Deklarimet për reduktimin e riskut të sëmundjes dhe deklarimet referuar zhvillimit dhe shëndetit të fëmijëve

1. Pavarësisht neni 3 (1) (b) të rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”, deklarimet e mëposhtme mund të bëhen aty ku ato janë të autorizuar për t’u përfshirë në listën e deklarimeve të lejuara, në përputhje me procedurën e përcaktuar



sipas legjislacionit evropian, së bashku me të gjitha kushtet e nevojshme për përdorimin e këtyre deklarimeve:

a) deklarimin për reduktimin e riskut të sëmundjes;

b) deklarimet që i referohen zhvillimit dhe shëndetit të fëmijëve.

2. Përveç kërkesave të përgjithshme të dhëna në këtë rregullore dhe kërkesave specifike të paragrafit 1, për etiketimin për deklarimet për reduktimin e riskut të një sëmundje ose në qoftë se etiketimi nuk ekziston, prezantimi ose reklamimi do të përmbajë një formulim që tregon se sëmundja së cilës i referohet deklarimi, ka faktorë risku të shumtë dhe ndryshimi i njërit prej këtyre faktorëve të riskut mund ose nuk mund të ketë efekte pozitive.

ANEKS

DEKLARIMI I VLERAVE USHQIMORE DHE KUSHTET QË ZBATOHEN NDAJ TYRE

Përmbajtje e ulët energjie

Deklarimi që ushqimi është me përmbajtje të ulët energjie dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti nuk përmban më shumë se 40 kcal (170kj)/100 g për produkte të ngurta ose më shumë se 20 kcal (80 kj)/ 100 ml për produkte të lëngshme. Për ëmbëlsuesit për diabetikët zbatohet limiti 4 kcal (17kj)/ porcion, me veti ëmbëlsuese ekuivalente me 6 g saharozë (afërsisht 1 lugë çaji saharozë).

Energji e reduktuar

Deklarimi që ushqimi është me përmbajtje energjie të reduktuar dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur vlera e energjisë është reduktuar të paktën me 30%, me një tregues të karakteristikave të cilat e bëjnë produktin ushqimor me energji të reduktuar në vlerën e tij të përgjithshme të energjisë.

Pa energji

Deklarimi që ushqimi është pa përmbajtje energjie dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti nuk përmban më shumë se 4 kcal (17kj)/100 ml. Për ëmbëlsuesit për diabetikët zbatohet limiti 0.4 kcal (1.7kj)/porcion me veti ëmbëlsuese ekuivalente me 6 g saharozë (afërsisht 1 lugë çaji saharozë).

Përmbajtje e ulët yndyre

Deklarimi që ushqimi është me përmbajtje të ulët yndyre dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti përmban jo më shumë se 3 g yndyrë/100 g produkt të ngurtë ose 1.5 g yndyrë/100 ml produkt të lëngshëm (1.8 g yndyrë/100ml për qumështin gjysmë të skremuar).

Pa yndyrë

Deklarimi që ushqimi është pa përmbajtje yndyre dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin, mund të bëhet vetëm kur produkti përmban jo më shumë se 0.5 g yndyrë/100g ose 100 ml produkt. Megjithatë, deklarimet e shprehura si “x”% pa yndyrë (*fat-free*) ndalohet të bëhen.

Përmbajtje e ulët yndyre të ngopur

Deklarimi që ushqimi është me yndyrë të ngopur të ulët dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm në qoftë se shuma e acideve yndyrore të ngopura dhe acideve transyndyrore në produkt nuk kalon 1.5g/100g produkt të ngurtë ose 0.75g/100ml produkt të lëngshëm dhe në secilin rast shuma e acideve yndyrore të ngopura dhe acideve transyndyrore nuk duhet të japë më shumë se 10% energji.

Pa yndyra të ngopura

Deklarimi që ushqimi nuk përmban yndyrë të ngopur dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur shuma e yndyrave të ngopura dhe acideve transyndyrore nuk kalon 0.1g yndyrë të ngopur/100g ose 100ml produkt.

Përmbajtje e ulët sheqeri

Deklarimi që ushqimi ka përmbajtje të ulët sheqeri dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti përmban jo më shumë se 5 g sheqer/100g produkt të ngurtë dhe 2.5g sheqer/100 ml produkt i lëngshëm.

Pa sheqer

Deklarimi që ushqimi është pa sheqer dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti përmban jo më shumë se 0.5g sheqer/100ml produkt.

Pa sheqer të shtuar

Deklarimi që nuk ka sheqer të shtuar në ushqim dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për



konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti nuk përmban monosaccharide ose disaccharide apo ndonjë ushqim tjetër që përdoret si embësues. Nëse sheqernat janë të natyrshme të pranishme në ushqim, treguesi i mëposhtëm duhet të paraqitet në etiketë “përmban sheqerna natyrale”.

Përmbajtje e ulët Na ripe

Deklarimi se ushqimi është me përmbajtje të ulët në natriumi/kripë, dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti përmban jo më shumë se 0,12 g natrium ose vlerë ekuivalente për kripë, për 100 g ose për 100 ml. Për ujërat, përveç ujërave minerale natyrale, që përfshihen në urdhrin nr. 266, datë 29.8.2011, “Për miratimin e rregullores “Mbi shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale””, kjo vlerë nuk duhet të kalojë 2 mg Na për 100 ml.

Përmbajtje shumë e ulët natriumi/kripë

Deklarimi se ushqimi ka përmbajtje shumë të ulët natriumi/kripë dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti përmban jo më shumë se 0,04 g natrium ose vlerë ekuivalente kripë, për 100 g ose për 100 ml. Ky deklarim nuk do të përdoret për ujërat minerale natyrale dhe ujërat e tjera.

Pa Na ose pa kripë

Deklarimi se ushqimi nuk ka Na ose kripë të shtuar dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm aty kur produkti përmban jo më shumë se 0,005 g natrium ose vlerë ekuivalente kripë, për 100 g.

Burim fibrash

Deklarimi se ushqimi është një burim i fibrave dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin, mund të bëhet vetëm atëherë kur produkti përmban të paktën 3g fibra në 100 g ose të paktën 1.5 g fibra për 100 kcal.

Përmbajtje e lartë fibrash

Deklarimi se ushqimi ka përmbajtje të lartë fibrash dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm atëherë kur produkti përmban të paktën 6 g fibra në 100 g apo të paktën 3 g fibra në 100 kcal.

Burim proteinash

Deklarimi se ushqimi është burim i proteinave dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm atëherë kur të paktën 12% e vlerës energjetike të ushqimit është nga proteina.

Përmbajtje e lartë proteinash

Deklarimi se ushqimi ka përmbajtje të lartë proteinash dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur të paktën 20% e vlerës energjetike të ushqimit është nga proteina.

Burim (emri i vitaminës/ave dhe/ose emri i mineralit/ve)

Deklarimi se ushqimi është burim i vitaminave dhe/ose mineraleve dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm atëherë kur produkti përmban të paktën një sasi të konsiderueshme, siç përcaktohet në aneksin VI të VKM-së nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore””.

Përmbajtje e lartë (emri i vitaminës/ave dhe/ose emri i mineralit/eve)

Deklarimi se ushqimi ka përmbajtje të lartë vitaminash dhe/ose mineraleve dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm atëherë kur produkti përmban të paktën dy herë vlerën e “burimit të (emri i vitaminës/ave dhe/ose emri i mineralit/eve)”.

Përmban (emri i lëndës ushqyese apo substance tjetër)

Deklarimi se ushqimi përmban një lëndë ushqyese ose substancë tjetër, për të cilat kushtet e veçanta nuk janë të përcaktuara në këtë Rregullore ose çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur produkti përputhet me të gjitha dispozitat e zbatueshme të kësaj rregulloreje dhe, në veçanti, nenin 5 të kësaj Rregulloreje. Për vitaminat dhe mineralet kushtet e deklarimit “burim”, do të zbatohen.

I rritur (emri i lëndës ushqyese)

Deklarimi se përmbajtja e një ose më shumë lëndëve ushqyese, përveç vitaminave dhe mineraleve, është e rritur dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm aty ku produkti i plotëson kushtet për kërkesën “burim...” dhe rritja e përmbajtjes është të paktën 30%, krahasuar me një produkt të ngjashëm.

I reduktuar (emri i lëndës ushqyese)

Deklarimi se përmbajtja e një apo më shumë lëndëve ushqyese është e reduktuar dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur reduktimi



në përmbajtje është të paktën 30% në krahasim me një produkt të ngjashëm, me përjashtim të micronutrients, ku një ndryshim 10% në vlerat referuese të përcaktuara do të jetë e pranueshme dhe për natrium ose vlera ekuivalente për kripën, një ndryshim 25% do të jenë të pranueshme.

Deklarimi “përmbajtje e reduktuar e yndyrave të ngopura” dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin, mund të bëhet vetëm:

a) nëse shumica e acideve yndyrore të ngopura dhe i acideve transyndyrore në produkt, është të paktën 30% më pak se shumica e acideve yndyrore të ngopura dhe të acideve transyndyrore në një produkt të ngjashëm; dhe

b) nëse përmbajtja e acideve transyndyrore në produkt është e barabartë me ose më pak se sa në një produkt të ngjashëm.

Deklarimi “përmbajtje e reduktuar sheqernash” dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm në qoftë se sasia e energjisë së produktit të deklaruar është e barabartë me ose më pak se sasia e energjisë në një produkt të ngjashëm.

Përmbajtje e ulët/pak

Deklarimi se produkti është me përmbajtje të ulët apo “të paktë” dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin, do të ndjekë të njëjtat kushte si ato të përcaktuara për termin “përmbajtje e reduktuar”; kërkesa duhet të shoqërohet me një tregues të karakteristikës/ave, të cilat e bën/jnë produktin ushqimor me “përmbajtje të ulët” ose “përmbajtje të paktë”.

Përmbajtje natyrale/natyrall

Kur ushqimet në mënyrë natyrale plotësojnë kushtin/et e përcaktuar në këtë aneks për përdorimin e deklaratës ushqyese, termi “përmbajtje natyrale/natyrall” mund të përdoret si një parashtesë në deklarim.

Burim i acideve yndyrore omega-3

Deklarimi se ushqimi është burim i acideve yndyrore omega-3 dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin, mund të bëhet vetëm atëherë kur produkti përmban të paktën 0,3 g acid alfa-linolenic për 100 g dhe për 100 kcal ose

të paktën 40 mg e shumës së acidit eicosapentaenoic dhe acidit docosahexaenoic për 100 g dhe për 100 kcal.

Përmbajtje e lartë e acideve yndyrore omega-3

Deklarimi se ushqimi ka përmbajtje të lartë me acide yndyrore omega-3 dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm atëherë kur produkti përmban të paktën 0,6 g acid alfa-linolenic për 100 g dhe për 100 kcal ose të paktën 80 mg i shumës së acidit eicosapentaenoic dhe acidit docosahexaenoic për 100 g dhe për 100 kcal.

Përmbajtje e lartë e yndyrave me një lidhje të pangopur (*monounsaturated*)

Deklarimi se ushqimi ka përmbajtje të lartë të yndyrave me një lidhje të pangopur (*monounsaturated*), dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur të paktën 45% të acideve yndyrore të pranishme në produkt rrjedhin nga yndyra me një lidhje të pangopur, me kusht që kjo e fundit siguron më shumë se 20% të energjisë së produktit.

Përmbajtje e lartë e yndyrave me shumë lidhje të pangopura (*polyunsaturated*)

Deklarimi se ushqimi është me përmbajtje të lartë të yndyrave me shumë lidhje të pangopura (*polyunsaturated*) dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur të paktën 45% të acideve yndyrore të pranishme në produkt rrjedhin nga yndyra me shumë lidhje të pangopura, me kusht që kjo siguron më shumë se 20% të energjisë së produktit.

Përmbajtje e lartë e yndyrave të pangopura

Deklarimi se ushqimi është me përmbajtje të lartë të yndyrave të pangopura dhe çdo deklarim tjetër që ka të njëjtin kuptim për konsumatorin mund të bëhet vetëm kur të paktën 70% të acideve yndyrore të pranishme në produkt rrjedh nga yndyrat e pangopura, me kusht që këto sigurojnë më shumë se 20% të energjisë së produktit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 350 lekë